



**LALAJ &
PARTNERS**
LEGAL & CONSULTING

Ligji Nr. 124/2024
Për mbrojtjen e të dhënave personale

10 Mars 2025

Ky prezantim synon të ofrojë një informacion të thjeshtuar mbi risitë e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ku do te fokusohemi:

- ❖ **Subjektet e ligjit dhe zbatimi territorial dhe**– Kush përfshihet dhe cilat janë rolet e tyre?
- ❖ **Të dhënat personale dhe ato sensitive** – Cilat janë?
- ❖ **Kriteret për përpunimin e të dhënave** – Kur dhe si mund të përpunohen të dhënat personale?
- ❖ **Përgjegjësitë e kontrolluesve dhe përpunuesve** – Si duhet të sigurohet përpunimi i drejtë dhe i sigurt i të dhënave?
- ❖ **Mbrojtja e të dhënave në projektim dhe mënyrë të paracaktua.**
- ❖ **Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave (DPO)** – Kur është i detyrueshëm dhe cilat janë detyrat e tij?
- ❖ **Të drejtat e subjekteve**- cilat jane ato?

Subjektet

Subjekt i të dhënave – Çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm.

KONTROLLUESI :

- Mund të jetë një subjekt privat (person fizik ose juridik) ose autoritet public.
- Përcakton qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.
- Mban përgjegjësi për përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

PËRPUNUESI – Personi fizik ose juridik ose autoritet publik

- Përpunon të dhëna personale për llogari të kontrolluesit.
- Duhet të veprojë sipas udhëzimeve të kontrolluesit.
- Ka detyrimin të marrë masa për mbrojtjen e të dhënave.

“Përpunimi” i të dhënave personale përfshin çdo veprim të kryer mbi to, me mjete të automatizuara ose jo, duke përfshirë mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, modifikimin, përdorimin, shpërndarjen, kufizimin, fshirjen ose shkatërrimin e tyre.

Zbatimi territorial

Brenda territorit të Shqipërisë

- Në kuadër të veprimtarive të një **kontrolluesi** ose **përpunuesi** të vendosur në Shqipëri, pavarësisht nëse përpunimi ndodh brenda ose jashtë vendit.

Jashtë Shqipërisë, por që prek subjekte në Shqipëri

- Kur një kontrollues i vendosur jashtë Shqipërisë përpunon të dhëna të individëve në Shqipëri, për:
 - Ofrimin e shërbimeve ose mallrave, me pagesë ose falas.
 - Monitorimin e sjelljes së subjekteve të të dhënave në Shqipëri.

Përpunimi sipas së drejtës ndërkombëtare

- Kur ligji shqiptar aplikohet mbi përpunues të vendosur jashtë Shqipërisë, bazuar në traktate ndërkombëtare ose të drejtën publike ndërkombëtare.

Të dhënat personale

Çfarë janë të dhënat personale?

Të dhënat personale përfaqësojnë çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, si emri, numri i identifikimit, adresa, të dhënat e kontaktit apo edhe sjellja digjitale e një individi.

Të dhënat sensitive përfshijnë informacione mbi origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimet fetare, anëtarësimin në sindikata, të dhënat shëndetësore, orientimin seksual, si dhe të dhënat biometrike dhe gjenetike.

- Të dhënat biometrike, si gjurmët e gishtave, skanimi i fytyrës dhe irisit, të cilat përdoren për identifikim të sigurt.
- Të dhënat gjenetike, janë të dhëna personale që zbulojnë karakteristikat e trashëguara ose të fituara të një individi dhe rrjedhin nga analiza e materialit biologjik, duke dhënë informacion mbi shëndetin ose identitetin.

Kriteret për përpunimin e të dhënave

Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse plotësohet të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

Pëlqimi – Subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij të qartë për një ose më shumë qëllime specifike.

Kontrata – Përpunimi është i nevojshëm për ekzekutimin e një kontrate ku subjekti është palë ose për të ndërmarrë hapa para lidhjes së kontratës.

Detyrimi ligjor – Përpunimi është i nevojshëm për të përmbushur një detyrim ligjor të kontrolluesit.

Interesi jetik – Përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose një personi tjetër.

Interesi publik – Përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre në interes publik ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar nga kontrolluesi.

Interesi legjitim – Përpunimi është i nevojshëm për interesat legjitime të kontrolluesit ose një pale të tretë, përveç rasteve kur të drejtat e subjektit mbizotërojnë mbi këto interesa.

Detyrimet e Reja për Kontrolluesit dhe Përpunuesit

Mbrojtja e të dhënave në projektim dhe mënyrë të paracaktuar

- Integrimi i masave të mbrojtjes së të dhënave **by design** dhe **by default** për të reduktuar rreziqet.
- Inkurajimi i përdorimit të **teknologjive të sigurta** nga kontrolluesit dhe përpunuesit.

Njoftimi i Komisionerit dhe subjekteve

- **Detyrim për raportim** në rast të një shkeljeje të të dhënave personale.
- Njoftimi i subjekteve të të dhënave **kur rreziku është i lartë**.

Detyrimet e Reja për Kontrolluesit dhe Përpunuesit

Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave**

- Kryerja e një **analize të rreziqeve** përpara nisjes së një përpunimi që mund të cenojë të drejtat dhe liritë e individëve.
- Marrja e masave për **minimizimin e rrezikut** nëse përpunimi është me rrezik të lartë.

Konsultimi paraprak me Komisionerin**

- Përpunimi i të dhënave me rrezik të lartë nuk mund të nisë pa miratimin e Komisionerit.

Emërimi i Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO)

- Detyrim për **organet publike dhe private** për të garantuar përputhshmërinë me ligjin.

Hartimi i kodeve të sjelljes**

- Për kategori të veçanta të **kontrolluesve dhe përpunuesve**, për të siguruar zbatim më të mirë të ligjit.

Mbrojtja që në projektim (by design)

- Në momentin e përcaktimit të mjeteve të përpunimit, kontrolluesi duhet të integrojë **masa sigurie**, si **pseudonimizimi dhe minimizimi i të dhënave**.
- Duhet të merren parasysh **zhvillimet teknologjike, kostot e zbatimit dhe niveli i rrezikut** për të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Mbrojtja e paracaktuar (by default)

- Vetëm të dhënat e **nevojshme** për një qëllim specifik duhet të përpunohen.
- Kufizim në **sasinë e të dhënave të mbledhura, kohën e ruajtjes dhe aksesin** në to.
- Parandalimi i aksesit të paautorizuar ose rastësor.

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave (DPO)

Kush duhet të emërojë një DPO?

- ❖ **Autoritetet publike** dhe organizatat që përpunojnë sasi të mëdha të të dhënave personale.
- ❖ **Subjektet private** që kryejnë **monitorim sistematik** të individëve ose përpunojnë kategori të veçanta të të dhënave sensitive.

Roli dhe përgjegjësitë e DPO

- **Sigurimi i përputhshmërisë** me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
- **Këshillimi i organizatës mbi politikat dhe praktikat** e mbrojtjes së të dhënave.
- Monitorimi i aktiviteteve të përpunimit dhe ndërveprimi me **autoritetet mbikëqyrëse**.
- **Trajnimi dhe ndërgjegjësimi** i stafit për mbrojtjen e të dhënave.
- **Mbështetja e organizatës në rast shkeljesh të të dhënave** dhe raportimi i tyre sipas ligjit.

Cilat janë cilësitë që duhet të ketë një DPO?

- **Njohuri të thelluara** mbi legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.
- **Eksperiencë praktike** në zbatimin e politika privatësisë dhe sigurisë së të dhënave.
- **Aftësi analitike** për të vlerësuar dhe zbatuar teknika dhe organizative për sigurinë e të dhënave.
- **Pavarësi** në ushtrimin e detyrave, pa ndikim drejtuesit e organizatës.
- **Aftësi komunikuese dhe bashkëpunuese** me autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e të dhënave.



Te drejtat e subjekteve

Çdo individ ka të drejta mbi të dhënat e tij personale, të garantuara nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

- **E drejta për informim:** Subjekti i të dhënave ka të drejtë të dijë se **kush, si dhe pse** po përpunohen të dhënat e tij.
- **E drejta për akses:** Çdo individ mund të kërkojë **kopje të të dhënave** të tij që po përpunohen.
- **E drejta për korrigjim:** Kërkesa për **ndryshimin ose plotësimin** e të dhënave të pasakta ose të paplota.
- **E drejta për fshirje ("E drejta për t'u harruar"):** Subjekti mund të kërkojë **fshirjen e të dhënave** kur nuk ka më një bazë ligjore për përpunimin e tyre.

Te drejtat e subjekteve

E drejta për kufizimin e përpunimit: Kërkesa për pezullimin e përpunimit në raste të caktuara, si kur verifikohet saktësia e të dhënave.

E drejta për transferueshmërinë e të dhënave: Subjekti mund të kërkojë të dhënat në një format të strukturuar dhe t'i transferojë ato tek një kontrollues tjetër.

E drejta për të kundërshtuar përpunimin: Individët mund të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave për qëllime specifike, përfshirë marketingun e drejtpërdrejtë.

E drejta për të mos iu nënshtruar vendimmarrjes automatike: Subjekti ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve të bazuara vetëm në përpunim automatik, përfshirë profilizimin.

Faleminderit!

